



STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TË ALB-CRTV

NENI 1 SHOQËRIA

SHOQERIA ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR ALB-CRTV, është një shoqëri e krijuar nga Korporata e Përgjithshme e Radio Televizionit të Kinës për bashkëpunimin ndërkombëtar Tekniko Ekonomik (CRTV) e përfaqësuar nga shtetasi kinez Wang JINGFU, cilësi të cilën ai e ka fituar nga Vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të CRTL datë 21.01.2005,

NENI 2 BAZA LIGJORE

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e CRTL është krijuar në bazë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit Civil të R.Shqipërisë, Kapitulli II, për Personat Juridikë, Ligjit 7638 datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe Ligjit 7667 datë 29/01/1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

NENI 3 EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar që krijohet në Shqipëri nga Korporata e përgjithshme e Radio-Televizionit të Kinës për bashkëpunimin ndërkombëtar Tekniko-Ekonomik (CRTV) do të emërtohet "SHOQERIA ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR ALB-CRTL"

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria e ka Selinë në Tiranë, ne Rrugën Irfan Tomini, vila nr.155.
Kjo seli mund të ndryshohet në vartësi të shtrirjes së veprimtarisë së saj.

NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Zyrën e Regjistrat Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë .

Veprimtaria e Shoqërisë fillon nga dita e regjistrimit si Person Juridik në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe marrjen e Lejes së Ushtrimit të Profesionit nga Organet tatimore kompetente të Pushtetit Vendor.

Shtrirja e veprimtarisë tej afatit 15 vjeçar dhe shpërndarja ose pushimi para këtij afati mund të bëhet vetëm në kushtet e përcaktuara në këtë statut.

NENI 6 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

1. Sipërmarrja e ndërtimeve dhe instalimeve në fushën e radiotelevizionit si dhe të gjitha problemet e lidhura me to, sikurse janë edhe ato të përcaktuara në marreveleshjet dhe

kontratat e arritura në të kaluarën (si ajo e dt. 16.12.2003) apo dhe që do të arrihen në të ardhshmen midis DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RADIO-FILM-TELEVIZIONIT TË R.P. TË KINËS dhe DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RADIO TELEVIZIONIT PUBLIK SHQIPTAR (RTSH), si dhe midis CRTV dhe RTSH

Projektimi dhe zhvillimi në fushën e radios dhe të televizionit, të telekomunikacionit dhe të fushave të tjera të ekonomisë në tërësi.

3. Tregtimin dhe furnizimin e tregut shqiptar me paisje të radiove, të televizionit, të telefonisë, elektronike, mekanike si dhe artikujve dhe produkteve të ndryshëm të import eksportit me shumicë dhe pakicë.
4. Shërbime në fushën e turizmit dhe të kulturës (si psh. Celje të klubeve të ndryshme kulturore, aktivitete të ndryshme kulturore të prezantimit të kulturës dhe filmit kinez në Shqipëri etj)
5. Shërbime të ndryshme në fushën e informacionit, si dhe të tëra fushave të përmendura më lartë.
6. Shoqëria ka të drejtë të zgjerojë sferën e veprimtarisë së saj sipas nevojës.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themelar i Shoqerisë është pesëqind mijë US Dollarë (500.000\$US) i ndarë në 100 kuota me nga 5000\$US secila.

Ky kapital është depozituar në llogarinë bankare të saj të krijuar pranë Bankës së Tiranës. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga fondet në monedhë të huaj ose shqiptare, nga vlerat e tjera pasurore të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe nga materialet e tjera që nevoiten për veprimtarinë e saj.

CRTV është zotëruese e 100% kapitalëve te SH.P.K. ALB-CRTV ne Shqipëri.

NENI 8 DISPONIMI I KAPITALIT

ALB – CRTV SH.P.K.i është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të marrë në përdorim ose me qira dhe të blejë objekte pasurore të ndryshme, të luajtshme ose të paluajtshme, brenda territorit të R. së Shqipërisë, të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale ose jomateriale, duke përfshirë dhe të drejtën për t'u ofruar (shitje, huapërdorje ose qiradhënie) pasurinë e saj personave të tretë.

Në Republikën e Shqipërisë, ALB – CRTV SH.P.K. gjëzon të drejta sikurse çdo person tjetër juridik vendas apo i huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 9 PËRGJEGJËSITË MATERIALE

ALB – CRTV SH.P.K. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj.

Shoqëria mban rezikun e veprimtarisë së saj vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të. Njëkohësisht mban te gjitha perjegjësitë për të drejtat dhe detyrimet e borxheve.

NENI 10 VULA DHE LLOGARIA BANKARE

ALB – CRTV SH.P.K. ka vulën e saj me mbishkrimin “Shoqeria me Pergjegjësi të Kufizuar ALB – CRTV”. Vula është në formë të rrumbullakët.

ALB – CRTV SH.P.K. ka të hapur llogari rrjedhëse në bankë. Nëpërmjet bankës ajo kryen veprimet ekonomiko-financiare me partnerë të tjerë shqiptarë dhe të huaj, duke likujduar në lëkë ose në monedhë të huaj (sipas marrëveshjeve të përfunduara) dhe duke respektuar kurdoherë dispozitat ligjore.

NENI 11

KONTABILITETI DHE BILANCI

Kontabiliteti ekonomiko-financiar i shoqërisë mbahet në Shqipëri si dhe jashtë territorit të saj (në Kinë) me të njëjtën vlefshmëri.

Kontabiliteti financiar pasqyrohet në monedhë shqiptare dhe kineze.

Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë mbyllen në cdo muaj, në cdo 3 muaj, cdo 6 muaj dhe më 31 dhjetor të çdo viti. Miratimi dhe vlersimi i bilanceve periodike bëhet kur çmohet e arsyeshme nga Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Miratimi i bilancit kontabël vjetor bëhet po nga Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë por jo më vonë se 3 muaj nga data e nxjerjes së tij.

NENI 12

DOKUMENTET

Veprimitaria e ekonomiko financiare e Shoqërisë pasqyrohet në dokumentet që hartohen sipas kritereve të percaktuara nga organet e specializuara.

Aktet, kontratat, faturat, njoftimet, dokumentet që rregullojnë mardhëniet me bankat ose me organet e tjera të sistemit financiar dhe dokumentet e tjera të Shoqërisë kanë vlerë ligjore kur janë të nënshkruara nga Administratori i Përgjithshëm dhe kur përbajnjë vulën e saj.

Në mungesë të Administratorit të Përgjithshëm, dokumentet e përmendura më lartë kanë vlerë ligjore kur janë të nënshkruara nga Zv/Administratori i Përgjithshëm.

Në mungesë të Administratorit të Përgjithshëm dhe Zv/Administratorit të Përgjithshëm, dokumentet e përmendura më lartë kanë vlerë ligjore kur janë të nënshkruara nga tjetër personi i autorizuar me shkrim.

NENI 13

FITIMET DHE DETYRIMET

Fitimet neto të Shoqërisë nxirren pasi zbriten detyrimet ndaj kreditorëve, amortizimi i pasurisë së lujtshme dhe të palujtshme, kuotat për investimet, pagat, shpenzimet shoqërore, shpenzimet për lëndë të parë e ndihmëse si dhe çdo shpenzim tjetër në sektorët vartës të Shoqërisë.

Fitimet neto, pas veçimit të fondit prej 250% si fond rezervë për nevoja të ngutshme dhe 35% si investim për zgjerimin e aktivitetit rentabël të Shoqërisë shkojnë në CRTV në Kinë.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 14

ORGANET

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

-- ORTAKU I VETËM (I PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM
I SH.P.K.)

-- ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

NENI 15

ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM I SHOQËRISË

Administratori i Përgjithshëm i ALB-CRTV SH.P.K është përfaqësuesi i ortakut të vetëm të shoqërisë.

Administratori i Përgjithshëm i ALB-CRTV emërohet Z.Wang JINGFU në bazë të vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të CRTV datë 21/01/2005.

NENI 16

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETËM TË SHOQËRISË

Ortaku i vetëm i ushtron kompetencat e tij nëpërmjet përfaqësuesit të tij i cili është Administratori i Përgjithshëm. Këto kompetenca të ortakut të vetëm të realizuara nëpërmjet përfaqësuesit të tij përfshijnë:

1. Ndryshimin e statutit të Shoqërisë.
2. Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.
3. Transferimin e kapitaleve të Shoqërisë në banka të ndryshme.
4. Miratimin e krijimit të degëve të Shoqërisë.
5. Vazhdimin tej afatit të veprimitarës, shpërndarjen e parakohshme ose pushimin e veprimitarës së Shoqërisë.
6. Miratimin e raporteve të admiministrimit, të bilanceve, inventarëve dhe llogarive periodike e vjetore të përgatitura nga punonjësit e shoqërisë..
7. Emërimin dhe shkarkimin e zv/administratorit të përgjithshëm dhe punonjësve të shoqërisë.
8. Përcaktimin e strukturës dhe organikën drejtuese të Shoqërisë.
9. Organizimin e stafit të Shoqërisë dhe përcaktimin e fondit të pagave të punonjësve të shoqërisë.
10. Jep urdhra, udhëzime, porosi të gjithë stafit drejtues të Shoqërisë si dhe çdo punonjësi tjetër të Shoqërisë për mënyrën e veprimit dhe të realizimit të detyrave prej tyre. Këto urdhra, udhëzime e porosi janë të detyrueshme për tu zbatuar.
11. Kërkon kredi e nënshkruan kontrata ose akte të tjera me bankat dhe personat juridikë privatë ose shtetërorë, për zhvillimin normal të Shoqërisë.
12. Administratori i Përgjithshëm në mungesë të tij i delegon kompetencat e tij Zv/Administratorit të Përgjithshëm të parashikuara në këtë nen, me perjashtim të 8(tetë) pikave të para.

NENI 17

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT TË PËRGJITHSHËM

Përvec kompetencave të parashikuara në nenin 16 Administratori I Përgjithshëm ka dhe kompetencat e tij të parashikuara nga Ligji 7638 datë 19.11.1992 I Republikës së Shqipërisë.

NENI 18

ZV/ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM I SHOQËRISË

Zv/administratori i përgjithshëm i Shoqërisë emërohet nga Administratori i Përgjithshëm i saj.

Zv/administratori i Përgjithshëm i tanishëm i Shoqërisë është zt. Liu Dongsheng.

NENI 19

KOMPETENCAT E ZV/ADMINISTRATORIT TË PËRGJITHSHËM

1. Ndihamon Administratorin e Përgjithshëm në punë. Ka autoritet dhe merr përsipër të gjitha punet e ngarkuara nga Administratori i Përgjithshëm.
2. Në mungesë të Administratorit të Përgjithshëm, është i autorizuar nga ky i fundit që ta përfaqesojë atë në punë dhe ka kompetence të drejtë të drejtojë të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë, njëkohësisht edhe gjithmonë në zbatim të orientimeve të dhëna nga Administratori i Përgjithshëm.

NENI 20

DETÝRIMET E PUNONJËSVE TË SHOQËRISË

Administratori i Përgjithshëm, Zv/Administratori i përgjithshëm, si dhe të gjithë punonjësit e tjerë të Shoqërisë janë të detyruar:

Të zbatojnë Legjislacionin shqiptar në fuqi, kushtet e përcaktuara në këtë statut dhe akt themelin e Shoqërisë gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Të ruajnë sekretin profesional për veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë.

NENI 21

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Përfaqësimi me fuqi të plotë i Shoqërisë ndaj personave juridikë të tjerë i takon Administratorit të Përgjithshëm të saj dhe në mungesë të tij Zv/Administratorit të Përgjithshëm të saj ose në mungesë të të dyve personave të autorizuar me shkrim për ti zevëndësuar ata.

NENI 22

PUNËSIMI

Shoqëria, për nevojat e saj punëson punonjës nëpërmjet lidhjeve të kontratave individuale të punës me të punësuarit duke respektuar Kodin e Punës, Ligjin për sigurimet shoqërore në R. Sh.

NENI 23

SHPËRNNDARJA OSE PUSHIMI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË PARA AFATIT TË CAKTUAR.

Shoqëria merr fund në këto raste:

1. Kur bilancet vjetore të saj rezultojnë negative për 3 (tre)vjet me radhë.
2. Kapitali i saj reduktohet në një vlerë më të vogël se 70% kapitalit themeltar.
3. Kur vendoset shndrimi i Shoqërisë në një tjetër.
4. Kur ALB – CRTV SH.P.K vendos të pushojë veprimtarinë e saj.

NENI 24

PRISHJA DHE LIKUDIMI I SHOQËRISË

Në rastin e prishjes dhe likujdimit të Shoqërisë, Administratori i Përgjithshëm përcakton modalitetet e likujdimit, marrin masat e nevojshme për mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë për llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, likujdimin e menaxherëve dhe punonjësve të Shoqërisë.

NENI 25
DISPOZITA TË FUNDIT

Statuti i Shoqërisë përpilohet në 6 kopje në gjuhën kineze dhe atë shqipe.

Ky statut së bashku me akt themelin që i lidhet si pjesë përbërëse, mbasi lexohet e studiohet me kujdes nga përfaqësuesi i CRTV, duke u gjetur në pajtim me vullnetin e tij të lirë, nënshkruhet rregullisht sot më Tiranë më date 01/02/2005.

*Ortaku i vetëm i ALB-CRTV Sh.P.K.
I përfaqësuar nga Administratori I Përgjithshëm*

WANG JINGFU
Data : 01/02/2005



Penktuesi
Liang Enbo




STATUTI

I KORPORATES SE PERGJITHSHME TE BASHKEPUNIMIT TEKNIKO-EKONOMIK NDERKOMBETAR TE RADIO-TELEVIZIONIT TE KINES

Kapitulli i parë: Pergjithesimi

1. Sipas «ligjit të RP të Kinës mbi shoqëritë të pronësisë së gjithë popullit” dhe sipas “ligjit të administrimit të regjistrimit të personit juridik të RP të Kinës”, është hartuar ky statut.
2. Emri i kësaj shoqërije është : Korporata e Përgjithshme e Bashkëpunimit Ekonomiko-tregtare Ndërkombëtare të Radio-televizionit të Kinës (emer i shkurter: CRTV).
3. Objekti i krijimit të kësaj korporate është : Të punojë për zhvillimin e mëtejshëm në fushën e radio-televizionit të Kinës.
4. Korporata është person juridik me kapital 100 % shtetëror dhe është një shoqëri që merret me produktet speciale të radio-televizionit dhe me angazhimin e veprave dhe të forcave të punës.
5. Korporata konform ligjeve të Kinës funksionon si shoqëri e pavarur tregtare. Ajo përgjigjet për fitimet dhe humbjet e saj.
6. Adresa e selisë së CRTV-së : Pekin zona Sichen rruga Beibinhë numër A2 numër postar 100045

Kapitulli i dytë: Fondi i regjistruar

7. Të gjitha kapitalet e CRTV janë shtetërore.
8. Kapitali themeltar është 36 milionë juanë kinezë, nga i cili 8 milionë e 420 mijë janë të ngurtësuar dhe 27 milionë e 580 mijë janë të lëvizshme.

Kapitulli i tretë: Sfera e aktiviteti

Aktiviteti kryesor: angazhimi i veprave vendëse dhe të huaja në fushën e radio-televizionit; eksport i pajisjeve dhe lëndëve që nevojiten për veprat e sipërpermendura, dhe dërgimi i punonjesve në vende perkatese. Zhvillim i bashkepunimit të kraheve te punes me boten dhe dergimi i kraheve te punes te radio-film-televizionit ne vende perkatese; angazhimi i veprave te ndihmes ekonomike per boten; import-eksporti i pajisjeve, lendeve,aparateve, mjeteve te ndricimit te skenave, te sallave vallzuese dhe pjesave kembimi, mjete incizimi dhe produkte perkatese kimike, pajisje dhe aparate perkatese, elemente dhe pajisje elektronike; import-eksporti i mallrave te kategorise se trete te miratuara nga shteti ose rajoni dhe qe kane lidhje me angazhimin e veprave dhe me bashkepunimin e kraheve te punes me boten; import-eksporti i teknologjive te radio-televizionit; angazhim i veprave te ekspozitave dhe i shkembimit te teknologjive etj; projektim dhe montimi i veprave televizive me tela; angazhim special i veprave montimi te pajisjeve elektrike dhe mekanike.

Aktivitete te tjera: Shitja, rezervimi dhe transport i aparateve te radio-televizionit, te makinave te incizimit dhe te videos, pajisjeve te radio-televizionit, te pjeseve kembimi; projektim dhe konsultim i veprave te radio-televizionit.

Kapitulli i katërt : Organet

10. Korporata varet nga Drejtoria e Pergjithshme e Radio-Filim-Televizionit e Kines.
11. Te gjithet drejtoret e drejtorive dhe te filianeve te korporates emerohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Korporates.
12. Ne Korporaten vendosen inxhinieri i pergjithshem, ekonomiku i pergjithshem, akountanti i pergjithshem.
13. Ne Korporaten vendosen Zyra e Drejtorit te Pergjithshem, Drejtoria e kuadrove, Drejtoria e financave, Drejtoria e veprave, Drejtoria e tregtise, Drejtoria e përbartvajtjen e ambienteve të shoqërisë.
14. Në rast nevojë mund të hapen filiale brenda e jashtë vendit.

Kapitulli i pestë: Perfaqesuesi ligjor

15. Drejtori i përgjithshëm është PËRFAQESUESI LIGJOR.
16. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Radio Film

Televizionit të Kinës.

17. Drejtori i përgjithshëm drejton dhe koordinon aktivitetet e ndryshme të korporatës, përgjigjet në mënyrë të gjithanëshme për shoqerinë.

18. Drejtori i përgjithshëm si përfaqesues ligjor i korporatës ka për detyrë të zbatojë ligjet e vendit duke respektuar dhe të drejtat e sindikatës së punonjësve.

Kapitulli i gjashtë: Administrimi i aktiviteteve

19. Korporata zbaton rreptësisht ligjet, rregulloret e vendit; respekton rreptësisht kontratat e nënshkruara konform akteve ligjore ndërkombëtare të biznesit dhe zhvillon aktivitete tregtare në bazë reciproke me leverdi të dy palëve.

20. Korporata zbaton aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e financave .

21. Korporata paguan sipas ligjeve tatimet dhe taksat .

22. Në rast nevojë, korporata merr specialisë vendës dhe të huaj si këshilltarë ekonomik, teknik ose ligjor.

23. Në rast kur korporata vンドos të mbyllë aktivitetet e saj, ajo vepron sipas ligjeve të falimentimit të Republikës Popullore të Kinës.

Kapitulli i 7-të: Shtoja

24. Të gjitha opsjonet që nuk janë hartuar në këtë statut, zgjidhen konform ligjeve përkatëse të shtetit.


25. E drejta e shpjegimit të këtij statuti i përket korporatës.

Korporata e Përgjithshme e Bashkëpunimit

Tekniko-Ekonomik Nderkombëtar e Radio-Télévisionit te Kines

Me daten 4 prill 2003 u rishkrua







AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR

TË ALB – CRTV

Sot me datë 01/02/2005, këtu në Tiranë pranë selise qendrore të Zyrës së përfaqesimit të CRTV me adresë Rr. Irfan Tomini nr.155 unë WANG JINGFU nënshtetas kinez me pasaport nr. P.5995228 në zbatim të VENDIMIT datë 21/01/2005 me titull “Vendim mbi krijimin e shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar në Shqipëri” nga Drejtoria e Përgjithshme e Korporata e Përgjithshme e Radio-Televizionit të Kinës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Tekniko-Ekonomic (Shkurtimisht quhet CRTV);

Deklaroj: nën cilësinë e përfaqësuesit të CRTV

Themelimin e SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TË ALB – CRTV.

Shoqëria do të ketë selinë e saj qendrore në Tiranë me adresë Rr. Irfan Tomini nr.155.

I. Objekti I veprimitarisë së Shoqërisë do të jetë si me poshtë vijon:

1. Sipërmarrja e ndërtimeve dhe instalimeve në fushën e radiotelevizionit si dhe të gjitha problemet e lidhura me to, sikurse janë edhe ato të përcaktuara në marreveleshjet dhe kontratat e arritura në të kaluarën (si ajo e dt. 16.12.2003) apo dhe që do të arrihen në të ardhshmen midis DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RADIO-FILM-TELEVIZIONIT TË R.P. TË KINËS dhe DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RADIO TELEVIZIONIT PUBLIK SHQIPTAR (RTSH), si dhe midis CRTV dhe RTSH.
2. Projektimi dhe zhvillimi në fushën e radios dhe të televizionit, të telekomunikacionit dhe të fushave të tjera të ekonomisë në tërësi.
3. Tregtimin dhe furnizimin e tregut shqiptar me paisje të radiove, të televizionit, të telefonisë, elektronike, mekanike si dhe artikujve dhe produkteve të ndryshëm të import eksportit me shumicë dhe pakicë.
4. Shërbime në fushën e turizmit dhe të kulturës (si psh. Celje të klubeve të ndryshme kulturore, aktivitete të ndryshme kulturore të prezantimit të kulturës dhe filmit kinez në Shqipëri etj.)
5. Shërbime të ndryshme në fushën e informacionit, si dhe të tëra fushave të përmendura më lartë.
6. Shoqëria ka të drejtë të zgjerojë sferën e veprimitarisë së saj sipas nevojës.

II. Shoqëria do të ketë statutin e saj në të cilin do të përcaktohet në mënyrë të zgjeruar objekti i veprimitarisë dhe funksionimit të saj.